



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**

Analizë

QEVERISJA LOKALE NË RAPORTIN E
KOMISIONIT EVROPIAN PËR KOSOVËN

Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tetor, 2022



Norwegian Embassy

DEM
Dialogue for European Municipalities

PËRMBAJTJA

Hyrje	2
TEMAT E ADRESUARA NË FUSHËN E QEVERISJES LOKALE	4
Zgjedhjet Lokale dhe Përfaqësimi Gjinor	4
Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale	4
Shoqëria Civile dhe Qeverisja Lokale	5
Administrata Publike	5
Ofrimi i Shërbimeve për Qytetarët	5
Lufta ndaj Korrupsionit	5
Parandalimi i Diskriminimit dhe Mbrojtja Sociale	6
Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe	6
Raportet/Rekomandimet e Auditorit	6

HYRJE

Raporti i Vendit për Kosovën 2022 shërben si pikë reference për institucionet e Bashkimit Evropian lidhur me vlerësimin e progresit të shtetit të Kosovës përgjatë rrugëtimit në BE. Në periudhën raportuese 2021- 2022, fusha e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është analizuar dhe vlerësuar në dimensione të ndryshme.

Në kontekstin e qeverisjes lokale, Raporti vëren dhe thekson pabarazinë ndërmjet komunave në performancën e tyre dhe ofrimin e shërbimeve. Sipas Raportit, Kosova ka nxjerr ligje për decentralizimin e një sërë kompetencave në fushën e shërbimeve sociale, mirëpo Qeveria e Kosovës ende nuk e ka miratuar plotësim-ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, ku parashihet ndarja e grantit të veçantë për shërbimet sociale, ngjashëm me grantin specifik për arsim dhe shëndetësi.

Mbi segmentin e të hyrave, Raporti vlerëson se komunat kanë një bazë shumë të ulët të të hyrave vetanake dhe thekson se ka ende hapësirë për përmirësim të mbledhjes së tatimit në pronë në veçanti. Raporti rekomandon se një mënyrë për përmirësimin e autonomisë fiskale dhe llogaridhënies komunale është rritja e grantit të përgjithshëm dhe vendosja e mekanizmave të ndarjes së të ardhurave.

Raporti evidenton progres me rritjen e numrit të konsultimeve online në nivel lokal, mirëpo qëndron dukshëm më i ulët se konsultimet e organizuara në nivel qendror nga ministritë përkatëse. Pjesëmarrja e publikut në procesin legjislativ është ende e kufizuar dhe inputet e ofruara nga shoqëria civile nuk janë pasqyruar sistematikisht në raportet e konsultimit publik.

Po ashtu, Raporti vendos theks të veçantë edhe tek përfshirja dhe pjesëmarrja e grave në nivel lokal, duke shprehur se numri i ulët i grave kandidatë për kryetare të komunave reflekton qartë pjesëmarrjen e ulët politike të grave në Kosovë. Raporti tregon se gjithsej 1937 gra (37%) kanë kandiduar për ulëse në kuvendet komunale, në përputhje me kuotën gjinore prej 30% për përfshirjen e grave në listat zgjedhore, dhe 36 prej tyre (12%) kryesojnë listat. Pak parti politike e kanë tejkaluar kuotën gjinore prej 30% dhe për këtë arsye nuk kanë arritur objektivin prej 50% për përfaqësim të paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore. Në këtë segment, nuk vërehet ndonjë përmirësim i dukshëm me gjetjet e vitit të kaluar sa i përket përfaqësimit të grave dhe Raporti rekomandon që partitë politike të trajtojnë seriozisht çështjen e pabarazisë gjinore në programet e tyre dhe të ndërmarrin veprime afirmative për të eliminuar pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen e grave në jetën politike.

Sa i përket zgjedhjeve lokale të vitit 2021, Raporti i cilëson si zgjedhje mirë të administruara dhe transparente. Për më tepër, këto zgjedhje janë parë edhe si konkurruese, në përjashtim të zonave me shumicë serbe. Raporti thekson se për shkak të zgjedhjeve lokale të vitit 2021, puna e Kuvendit u ngadalësua pasi deputetët u angazhuan në fushatën elektorale.

Edhe pse nuk është evidentuar ndonjë progres sa i përket integritetit dhe konfliktit të interesit, përpjekje të mëtejshme janë duke u zhvilluar për të forcuar sistemet e prokurimit të qeverisjes lokale dhe mbikëqyrjen e auditimit dhe gjithashtu një numër i madh i komunave janë duke i publikuar kontratat e prokurimit.

Analiza përfshin një përmbledhje të përgjithshme të të gjeturave nga Raporti për Vendin për rezultatet dhe progresin e arritur në fushën e qeverisjes lokale nga viti 2022, njëherësh sfidat dhe kriteret kyçe që duhet adresuar viteve në vijim. Fushat e paraqitura në këtë analizë, njëherësh të vlerësuara nga Raporti i Vendit janë si në vijim: Zgjedhjet Lokale dhe Përfaqësimi Gjinor; Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale; Shoqëria Civile dhe Qeverisja Lokale; Administrata Publike; Ofrimi i

Shërbimeve për Qytetarët; Lufta ndaj Korrupsionit; Parandalimi i Diskriminimit dhe Mbrojtja Sociale; Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe dhe Raportet/Rekomandimet e Auditorit.

Instituti KLGJ ka analizuar Raportin e Vendit për Kosovën, me fokus çështjet që lidhen me pushtetin lokal, për më tepër edhe politikat qendrore që shtrihen në komuna. Ky dokument shërben për institucionet, akterët publikë, shoqërinë civile dhe mediat si pikë referuese për sfidat e qeverisjes lokale. Ndërkaq, për Institutin KLGJ shërben si instrument në përshtatjen e strategjive dhe fushave të intervenimit në funksion të agjendës së përbashkët drejt reformave evropiane.

TEMAT E ADRESUARA NË FUSHËN E QEVERISJES LOKALE

● Zgjedhjet Lokale dhe Përfaqësimi Gjinor

- Raporti i Vendit për Kosovën thekson se zgjedhjet lokale të vitit 2021 kanë qenë mirë të administruara, transparente, si dhe konkurruese, me përjashtim të zonave me shumicë serbe;
- Gratë ende mbesin të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes: në partitë politike, administrata zgjedhore, si dhe kuvendet qendrore dhe lokale;¹
- Gjithsej 1937 gra (37%) kanë kandiduar për ulëse në kuvendet komunale, në përputhje me kuotën gjinore prej 30% për përfshirjen e grave në listat zgjedhore, dhe 36 prej tyre (12%) kryesojnë listat;
- Pak parti politike e kanë tejkaluar kuotën gjinore prej 30% dhe për këtë arsye nuk kanë arritur objektivin prej 50% për përfaqësim të paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore.²

● Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale

- Raporti i Vendit konstaton se është arritur sado pak progres në sigurimin e alokimit të fondeve për shërbimet sociale. Autoritetet kanë vendosur ndryshime në Ligjin për Financat Lokale për të caktuar financimin nga granti i përgjithshëm për komunat, mirëpo ende nuk janë votuar në Kuvend³;
- Raporti thekson se çdo institucion, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, ka njësi të menaxhimit të burimeve njerëzore, por kapacitetet duhet të përmirësohen⁴;
- Raporti rekomandon që komunat të bëjnë përpjekje për të përmirësuar planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, mbledhjen e të dhënave dhe kujdesin e integruar⁵;
- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal i konsultuar në shtator 2021, ende nuk është miratuar dhe ky ligj ka një grant specifik për shërbimet sociale, i cili do të rregullonte dhe përmirësonte ofrimin e shërbimeve sociale në komuna;
- Ngjashëm me vitin e kaluar, Raporti vlerëson se Kuvendet Komunale nuk luajnë një funksion të fortë mbikëqyrës mbi ekzekutivin komunal.⁶

¹ Raporti i Vendit 2022 për Kosovën. Kapitulli i demokracisë, f.7

² Kapitulli i demokracisë, f.8

³ Kapitulli i politikave sociale dhe punësimit, f.100

⁴ Kapitulli i shërbimeve publike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, f.14

⁵ Kapitulli i politikave sociale dhe punësimit, f.100

⁶ Kapitulli i qeverisjes, f.10

- **Shoqëria Civile dhe Qeverisja Lokale**

- Raporti evidenton progres me rritjen e numrit të konsultimeve online në nivel lokal, mirëpo qëndron dukshëm më i ulët se konsultimet e organizuara në nivel qendror nga ministrinë përkatëse;
- Pjesëmarrja e publikut në procesin legjislativ është ende e kufizuar dhe inputet e ofruara nga shoqëria civile nuk janë pasqyruar sistematikisht në raportet e konsultimit publik.⁷

- **Administrata Publike**

- Sipas Raportit, ekziston një nivel i përgatitjes në fushën e reformës së administratës publike.
- Raporti vlerëson disa hapa kryesorë pozitivë të cilët u ndërmorën duke zhvilluar strategji gjithëpërfshirëse për RAP-in dhe menaxhimin e financave publike (MFP) 2022-2026;
- Përderisa korniza legjislative për aspekte të ndryshme të RAP-it është pjesërisht e përcaktuar, Raporti nuk evidenton ndonjë progres sa i përket zbatimit;
- Pas vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2019, ndryshimet në vazhdim të Ligjit për Zyrtarët Publikë duhet të harmonizohen me parimet e RAP-it para miratimit. Vonesa në zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë ka dëmtuar organizimin e rekrutimit të centralizuar;
- Raporti i Vendit rekomandon që të përmirësohet funksionimi i shërbimit civil, duke përsheptuar zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë në përputhje me vendimin përkatës të Gjykatës Kushtetuese dhe me parimet e RAP-it, gjatë organizimit të rekrutimit të centralizuar.

- **Ofrimi i Shërbimeve për Qytetarët**

- Sipas Raportit të Vendit, zbatimi i Ligjit për Procedurat e Përgjithshme Administrative ka qenë i ngadalshëm⁸;
- Raporti vëren dhe thekson pabarazinë ndërmjet komunave në performancën e tyre dhe ofrimin e shërbimeve;
- Sipas Raportit, Kosova ka nxjerr ligje për decentralizimin e një sërë kompetencave të mirëqenies sociale dhe mbrojtjes sociale, por komunat ende nuk kanë marrë fonde për zbatimin e këtyre shërbimeve;
- Raporti rekomandon se një mënyrë për përmirësimin e autonomisë fiskale dhe llogaridhënies komunale është rritja e grantit të përgjithshëm dhe vendosja e mekanizmave të ndarjes së të ardhurave⁹.

⁷ Kapitulli i shoqërisë civile, f.11

⁸ Kapitulli i reformës së administratës publike, f.11

⁹ Kapitulli i qeverisjes, f.10

- **Lufta ndaj Korrupsionit**

- Raporti i Vendit thekson se planet e integritetit për të promovuar integritetin në shërbimin publik ekzistojnë, mirëpo zbatimi mbetet i kufizuar¹⁰;
- Raporti e parasheh nevojën e vazhdueshme për të promovuar përpunimin dhe miratimin e planeve të integritetit në shërbimin publik, si mjet për parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve joetike, duke përfshirë edhe nivelin komunal;
- Raporti nuk evidenton ndonjë zhvillim ose progres sa i përket integritetit dhe konfliktit të interesit, duke shprehur se kodi i etikës ekziston, mirëpo pajtueshmëria e tij nuk monitorohet.¹¹

- **Parandalimi i Diskriminimit dhe Mbrojtja Sociale**

- Raporti i Vendit vlerëson se politikat dhe legjislacioni për të drejtat themelore kërkojnë përmirësim, duke përfshirë koordinimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe komuniteteve joshumicë, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal;
- Ekzistojnë mekanizma dhe struktura të mira në nivel qendror dhe lokal si dhe një kornizë adekuate ligjore për të mbrojtur komunitetet joshumicë dhe të drejtat e tyre. Mirëpo, Raporti rekomandon që një koordinim dhe komunikim institucional ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes do të përmirësonte efektivitetin e tyre.¹²

- **Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe**

- Sa i përket integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në sistemin gjyqësor, Raporti vlerëson sukses në këtë drejtim, mirëpo ekzistojnë vazhdimisht dështime në sigurimin e zbatimit të dispozitave për përbërjen e paneleve për rastet që vijnë nga komunat me shumicë serbe, veçanërisht në Gjykatën e Apelit¹³;
- Qeveria finalizoi një marrëveshje me Serbinë si pjesë e Dialogut të facilituar nga BE-ja për adresimin e çështjeve të faturimit të energjisë elektrike në katër komuna në veri të Kosovës. Dhe, pas zbatimit të plotë të kësaj marrëveshje, Raporti vlerëson se kjo marrëveshje duhet të reduktojë ndjeshëm humbjet e ndërmarrjeve publike dhe subvencionet qeveritare për sektorin.¹⁴

- **Raportet/Rekomandimet e Auditorit**

- Raporti thekson se përpjekje të mëtejme janë duke u zhvilluar për të forcuar sistemet e prokurimit të qeverisjes lokale dhe mbikëqyrjen e auditimit, duke u rritur numri i komunave të cilat i publikojnë kontratat e prokurimit¹⁵;

¹⁰ Kapitulli i shërbimeve publike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, f.14

¹¹ Kapitulli i luftës ndaj korrupsionit, f.27

¹² Kapitulli i të drejtave themelore, f.29

¹³ Kapitulli i gjyqësorit dhe të drejtave themelore, f.18

¹⁴ Kapitulli i ekonomisë funksionale të tregut, f.61

¹⁵ Kapitulli i prokurimit publik, f.72

-
- o Raporti evidenton që kapacitetet administrative të njësive të auditimit të brendshëm në nivel qendror dhe lokal ende mungojnë¹⁶;
 - o Raporti e konsideron sfidues themelimin efektiv të komiteteve të auditimit të brendshëm në të gjitha organizatat buxhetore, duke përfshirë edhe nivelin komunal¹⁷;
 - o Zyra Kombëtare e Auditimit finalizoi 14 raporte të auditimit të performancës, krahasuar me 11 raporte në vitin 2020. Zyra ka punuar me organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht në nivel lokal, për të përmirësuar ndikimin e punës së auditimit dhe gjithashtu u zhvilluan debate publike në nivel komunal për rekomandimet e auditorit.¹⁸

¹⁶ Kapitulli i kontrollit financiar, f.76

¹⁷ Po aty

¹⁸ Kapitulli i kontrollit financiar, f.74



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**

Kosovo Local Government Institute
Address: Str. Enver Gjerqeku no. 20,
10000 Prishtinë, Republic of Kosova
Tel: +383 (0) 38 522 000
Mobile: +383 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | Web: www.klgi-ks.com